



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I PERSONELIT**

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË
NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE
SHPËTIMIN**

Në zbatim të ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ligji nr.139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr.520 datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Kreu i III “Ndarja e funksioneve, nivelet, detyrat, procedurat e përzgjedhjes për emërim, lirim pezullim dhe përjashtim”, Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.02, datë 14.01.2026, ”Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë Durrës”, dhe në Urdhrin nr.50 prot,1916 datë 06.02.2026, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Durrës njofton se në Drejtorinë e MZSH-së shpallen:

4 (katër) vende të lira pune në pozicionet:

- Personel zjarrfikës, 4 (katër) pozicione (niveli bazë)

1. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I VENDIT TË PUNËS

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut.

- Zjarrfikës, operues, luftues:

Punonjësi zjarrfikës (luftues, shpëtues, furnizues, evakues) është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë e të pronës.

Punonjësi zjarrfikës varet nga komandanti i shërbimit dhe përgjigjet për:

- a) marrjen e dorëzimit të shërbimit me përgjegjësi, duke kontrolluar pajisjet personale dhe të përbashkëta të shërbimit, njofton komandantin e shërbimit për mangësitë e vërejtura dhe ndihmon për eliminimin e tyre;
- b) njohjen mirë të detyrës së tij funksionale, duke u përpjekur maksimalisht për aftësimin profesional, duke qenë në çdo kohë në gatishmëri të plotë, duke ditur mirë radhën e veprimeve dhe duke vepruar me shpejtësi dhe saktësi me marrjen e sinjalit për dalje në operacion;
- c) marrjen e sinjalit të alarmit, vepron me shpejtësi dhe saktësi, si dhe pajiset me mjetet e tij personale dhe mjetet e nevojshme për operacionin. Pozicionohet në vendin e tij në

automjet dhe raporton gatishmërinë e tij për lëvizje. Gjatë udhëtimit për në vendngjarje komunikon me komandantin e shërbimit për të eliminuar ndonjë mangësi të vërejtur;

d) pozicionimin në formacion luftimi, zbatimin e detyrave dhe të urdhrave drejtuesit të operacionit (DSHZ), duke vepruar profesionalisht;

e) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me kolegët, si dhe me forcat e tjera operacionale që veprojnë në operacion. Për çdo problem të evidentuar raporton tek drejtuesi i operacionit;

f) të gjitha veprimet operacionale që kryen, dhënien prioritet ruajtjes dhe shpëtimit të jetës së njerëzve. Dhënien e “Ndihmës së Parë” kur kërkohet, të punojë në grup me zjarrfikësit e tjerë duke dhënë maksimumin e kontributit të tij në sigurinë e jetës së kolegut dhe shpëtimin e jetës së njerëzve.

1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- d) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- e) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- f) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- g) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- h) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- i) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- j) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- k) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- l) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- m) Të jetë me peshë trupore që t’i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- n) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit “C”;
- o) Kandidati për personelin drejtues automjeteve zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi “D”, si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist, me leje drejtimi automjeti, grupi “D”, etj.

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së.
- b) Fotokopje e kartës së identitetit ;
- c) Çertifikatë familjare;
- d) Një kopje të jetëshkrimit(CV);
- e) Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- f) Fotokopje deftesë pjekurie;apo diplome.
- g) Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
- h) Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
- i) Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)/ Formular vetëdeklarimi ;
- j) Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
- k) Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
- l) Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “C”;
- m) Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- n) Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) copë.

- REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

- Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës.

Dokumentat duhet të dorëzohen në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë Durrës brenda datës 17.02.2026 .

Afati i ankimimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

3. FUSHA KRYESORE MBI TË CILËN BAZOHET KONKURIMI

- Ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- VKM nr. 520 dt.25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri ”

4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a. Testim me shkrim
- b. Testim i aftësive fizike;
- c. Intervistë me gojë;
- d. Testimi psikologjik;
- e. Verifikim përfundimtar i aplikantit.

- **Procedura e konkurrimit do të ndjekë këto faza:**

- **Testimi me shkrim**, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.

- **Testimi i aftësive fizike**, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

- **Intervista me gojë** konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

- **Testimi psikologjik** konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal. Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

- Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

-

- **Afati i ankimimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.**

5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesit do të shpallen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail). Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës.